



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1697/3 Prot

Durrës, më: 2. 7. 2026

V E N D I M

Nr. 102, datë 2. 7. 2026

PËR

**"MIRATIMIN PARAPRAK TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR PROGRAMET E
CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR
MOISIU", Durrës, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027".**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 3 "*Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë*", pika 3/ç ku citohet se: "*Autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj*"; në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës; në Vendimet respektive të Bordit të Administrimit për miratimin e tarifave të studimit, si dhe në relacionin Nr. 1686/1 prot., datë 01.07.2026 të Drejtorisë së Administrimit Financiar, në mbledhjen e datës 02.07.2026 Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraprak të tarifave të shkollimit për studentët që regjistrohen në programet e ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2026–2027, sipas Tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Tarifa e regjistrimit për kandidatët fitues që regjistrohen për herë të parë në një program të parë studimi të ciklit të dytë të jetë **2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë**.
3. Tarifa e regjistrimit për kandidatët fitues që regjistrohen për herë të parë në një program të dytë studimi të ciklit të dytë të jetë **5 000 (pesë mijë) lekë**.
4. Tarifa e aplikimit për studentët që transferojnë studimet nga një institucion tjetër i arsimit të lartë në një program të parë studimi të ciklit të dytë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të jetë **3 000 (tre mijë) lekë**.
5. Tarifa e aplikimit për studentët që transferojnë studimet në një program të dytë studimi të ciklit të dytë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të jetë **5 000 (pesë mijë) lekë**.
6. Studentët që regjistrohen në programe studimi të ciklit të dytë me **120 kredite** (kohëzgjatje normale dy vite akademike) ta paguajnë tarifën e shkollimit në tre kështe:
 - kësti i parë në masën **25%** të tarifës së plotë, në momentin e regjistrimit;

- kësti i dytë në masën **25%**, para fillimit të semestrit të dytë të vitit të parë të studimeve;
 - kësti i tretë në masën **50%**, para fillimit të vitit të dytë të studimeve.
7. Studentët që regjistrohen në programe studimi të ciklit të dytë me **60 kredite** (kohëzgjatje normale një vit akademik) ta paguajnë tarifën e shkollimit në dy këste:
- kësti i parë në masën **50%** të tarifës së plotë, në momentin e regjistrimit;
 - kësti i dytë në masën **50%**, para fillimit të semestrit të dytë.
8. Kandidatët që kanë përfunduar me sukses një program studimi dhe regjistrohen në një program të dytë studimi të ciklit të dytë t'i nënshtrohen tarifës së shkollimit sipas Tabelës nr. 2, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer, sipas legjislacionit në fuqi.
9. Shtetasit e huaj që ndjekin studimet në programet e ciklit të dytë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, t'i nënshtrohen të njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, përveç rasteve kur marrëveshjet zyrtare ndërinstitucionale ose ndërkombëtare parashikojnë ndryshe.
10. Studentët e ciklit të dytë të studimeve të paguajnë tarifën e plotë të shkollimit sipas programit të studimit dhe numrit të krediteve përkatëse.
11. Kategoritë e studentëve që ndjekin një program të parë studimi të ciklit të dytë dhe përfitojnë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit të jenë ato të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018, si dhe në aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
12. Ky vendim i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

